

FORMULARI NUMËR 3

KONCEPTDOKUMENTI PËR KRYEPROKUROR

Mbiemri:	Ismajli
Emri:	Arben

Bazuar në kompetencat ligjore të parapara për pozitën që aplikoni, ju lutem të ofroni:

I. Analizën tuaj, si vijon:

1. Si e vlerësoni gjendjen aktuale në Prokurorinë e Shtetit?

Sistemi prokurorial në Republikën e Kosovës është zhvilluar dhe administruar bashkërisht me partnerët ndërkombëtarë. Këto kompetenca të përziera në një formë apo tjetrën kanë ndikuar në konsolidim dhe avancim të sistemit të drejtësisë.

Pas shpalljes së pavarësisë së Republikës së Kosovës, për sistemin e drejtësisë kishte filluar një periudhë e re, duke zotëruar pavarësinë e Prokurorit të Shtetit, në bazë të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, e që kjo pavarësi mundësoi zhvillimin e sistemit të drejtësisë si në aspektin ligjor, rregullativ dhe në atë ekzekutiv në kompetencat e ndjekjes së kryerësve të veprave penale.

Pas krijimit të këtij realitetit, si ndër të arriturat më të mëdha, konsiderohet themelimi i Këshillit Prokurorial të Republikës së Kosovës dhe rregullimi i funksioneve të Prokurorit të Shtetit, e po ashtu edhe themelimi i Zyrës së Prokurorisë Speciale të Republikës së Kosovës si zyrë e përhershme dhe e specializuar prokuroriale që operon nën hierarkinë e Zyrës së Prokurorit të Shtetit të Kosovës.

Nga viti 2013 deri më tani, Këshilli ka hartuar dhe miratuar rregullore për funksionalizimin dhe operacionalizimin e punës së Prokurorit të Shtetit, pa dyshim që me miratimin e këtyre akteve nënligjore, janë avancuar të gjitha aspektet e punës së sistemit prokurorial, ku ndër to vlen të përmendet procedurat e emërimit dhe rrimërimit të prokurorëve, procedurat e zgjedhjes së Kryesuesit, zëvendës Kryesuesit dhe anëtarëve të Këshillit, procedurat e zgjedhjes së Kryeprokurorit të Shtetit, procedurat e zgjedhjes së kryeprokurorëve të prokurorive, vlerësimi i performancës së prokurorëve, procedurat disiplinore ndaj prokurorëve, transferimi dhe avancimi i prokurorëve, organizimi i brendshëm i Këshillit dhe Prokurorit të Shtetit, komunikimi me publikun, klasifikimi i informacioneve në sistemin

prokurorial, shfrytëzimi i teknologjisë informative, ndarja dhe administrimi i lëndëve, procedura e ndërmjetësimit, trajnimet e prokurorëve dhe stafit, arkivimi dhe protokollimi i dokumenteve, norma orientuese për prokurorët, menaxhimi i pasurisë jo financiare, shpenzimi i parasë publike, etj.

Pas kësaj infrastrukture ligjore janë vërejtur edhe të arriturat dhe rezultatet në punën operative, në luftimin e dukurive negative, ne po e paraqesim vetëm disa të dhëna të përgjithshme, të cilat e tregojnë gjendjen e Prokurorit të Shtetit në të kaluarën dhe të tanishme, gjersa në vitin 2013 ngarkesa me lëndë për një prokurorë ka qenë 394.5 % lëndë për një prokuror, ndërsa sot ngarkesa me lëndë është përafërsisht 177.10 % për prokuror, që nënkupton se ngarkesa me lëndë është zvogëluar për 60%.

Me gjithë këtë avancim, sidomos në trajtimin e lëndëve, konsideroj që sistemi prokurorial në gjendjen aktuale ka nevojë për avancim të profesionalizimit, llogaridhënie më të madhe, cilësi më të mirë të akteve prokuroriale, përfaqësim më adekuat, angazhim më të madh në sekuestrim dhe konfiskim të përhershëm të pasurisë, qasje transparente para opinionit publik dhe angazhim më të madh në luftën kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar, por edhe për vepra penale, për cilën konsideroj se janë sfida dhe mungon suksesi i mjaftueshëm.

Po ashtu, ndaj Prokurorisë së Apelit dhe sistemit të drejtësisë në përgjithësi, është krijuar një perceptim në opinion publik se gjendja e përgjithshme në organin e akuzues është jo e kënaqshme, andaj ne do të angazhohemi, që këto sfida të sistemit prokurorial t'i avancojmë, duke siguruar pavarësi të plotë për funksionim të Prokurorit të Shtetit, paanshmëri dhe objektivitet me rastin e trajtimit të rasteve penale, llogaridhënie, transparencë, profesionalizëm, trajtim në mënyrë të barabartë dhe me efektivitet të të gjitha rasteve penale.

2. Si vlerësoni gjendjen aktuale në Prokurorinë në të cilën keni aplikuar?

Prokuroria e Apelit është themeluar me ligj kur është bërë riorganizimi i prokurorive dhe gjykatave nga 1 janari i viti 2013, dhe është përcjellë me sfida të ndryshme që kanë pasur të bëjnë lidhur me praktikën me të mira, nga fakti se ka qenë një institucion i ri i themeluar me ligj.

Prokurori e Apelit tani konsideroj se pas këtyre viteve, ka arritur të ketë një konsolidim, për faktin që tani ka një numër të mjaftueshëm të prokurorëve dhe atë 4 prokuror në Departamentin e Krimeve të Rënda, 1 prokuror në Departamentin për të Mitur dhe 6 prokuror në Departamentin e Përgjithshëm dhe Kryeprokurori i Prokurorisë së Apelit, gjithsejtë 12 prokuror dhe janë përmbushur nevojat e Prokurorisë së Apelit. Ekziston infrastruktura ligjore si ajo themelore dhe ajo dytësore dhe ka edhe udhëzime specifike nga Zyra e Kryeprokurorit të Shtetit, për ta ndihmuar punën e Prokurorisë së Apelit, lidhur me zbatimin e dispozitave penale dhe procedurale, e që kanë ndikuar në efikasitet, kontroll dhe profesionalizim.

Përparësi tjetër, konsiderohet krijimi i Departamentit për të mitur, në fillimin e vitit 2024 dhe caktimi i një prokurori për trajtimin e lëndëve që kanë bëjnë me të miturit si kryerës të veprave penale dhe rastet ku të miturit janë të dëmtuar që parashihet me ligj në kompetencë të Departamentit për të mitur.

Gjithashtu si përparësi konsiderohet se aktualisht për shkak të avancimit të prokurorëve në prokurorinë e Apelit, është zvogëluar dukshëm numri i lëndëve dhe tani as që mund të flitet për vonesa të pajustificuar por të gjitha lëndët kryhen brenda afateve ligjore.

Nxjerrja e ligjit për përgjegjësi disiplinore për gjyqtar dhe prokuror dhe Kodi i Etikës Profesionale për Prokuror, kanë avancuar mbikëqyrjen dhe llogaridhënien, profesionalizmin dhe transparencës.

Gjithashtu administrimi dhe ndarja e lëndëve përmes sistemit elektronik "SMIL" dhe kriteret e reja të vlerësimit të performancës për prokurorët, si dhe takimet e rregullta dhe bashkëpunimi me Prokuroritë Themelore, PSRK-ë, dhe Prokurorinë e Shtetit me bartësit e organeve të tjera të zbatimit të ligjit dhe partnerëve ndërkombëtar.

Si dhe krijimi i mekanizmave përcjellës për realizimin e raporteve statistikore për punën e Prokurorit të Apelit, raportet e rregullta dhe raportimi i tyre për të gjithë regjistrat.

3. Cilat janë mangësitë dhe sfidat kryesore të kësaj prokurorie?

Sa i përket mangësive kryesore të Prokurorisë së Apelit, konsideroj se edhe përkundur zhvillimeve pozitive, ka ende mangësi të cilat do të na përcjellin edhe më tutje dhe kërkojnë angazhim, objektiva dhe planifikim të qartë për t'i evituar mangësitë, po i përmendin disa prej tyre:

- Ndryshimet e shpeshta ligjore, posaçërisht ato të Kodit Penal dhe Kodit të Procedurës Penale.
- Mungesa e zyrtarëve të Lartë për Bashkëpunim Profesional.
- Mungesa e zyrtarëve Ligjor
- Mungesa e zyrave për prokuror dhe stafin administrativ
- Numri i madhe i lëndëve nga regjistrat PAR, PPA, AKAP etj.
- Llogaridhënia e pamjaftueshme dhe cilësia e akteve prokuroriale.
- Mos pjesëmarrja në seanca të kolegjit
- Krijimi i perceptimit negativ në opinionin publik.

4. A mendoni se strategjitë aktuale të sistemit adresojnë nevojat e prokurorisë për të cilën aplikoni?

Sistemi i drejtësisë në përgjithësi, duke përfshirë edhe sistemin prokurorial dhe sistemin gjyqësor kanë kaluar nëpër reforma të shumta, sistemi prokurorial për vite me radhë është ballafaquar me numër në rritje të lëndëve dhe numër të pa mjaftuar të prokurorëve dhe stafit administrativ.

Në mungesë dhe si rezultat e tyre është rritur numri i lëndëve edhe pse të gjitha lëndët në fund të vitit janë përfunduar, pasi që natyra e lëndëve në Prokurorinë e Apelit dallon nga natyra e lendeve të shkallës së parë, andaj raportet vendore dhe ndërkombëtare kanë vlerësuar se progresi është në rritje e sipër.

Në këtë kontekst është rekomanduar që të ndërmerren masa konkrete për fuqizimin e pavarësisë, paanësisë, integritetit, llogaridhënies, transparencës, efikasitetit dhe profesionalizmit të sistemit prokurorial.

Strategjitë aktuale të sistemit adresojnë nevojat e institucionit dhe menaxhmentit të tij dhe krahasohen me strategjitë dhe kornizat e politikave të institucioneve në nivel shtetëror ngase koordinimi i tille siguron planifikim të drejtë dhe të saktë si dhe është garantues i rezultateve pozitive.

Mendoj se KPK-ë, dhe PSH-ë, do të punojnë që Prokuroria e Apelit, si prokurori e shkallës së dytë do ti përcaktojnë prioritetet dhe kriteret e shqyrtimit të lëndëve të cilat kanë të bëjnë me vendosjen lidhur me ankesat e palëve kundër aktvendimeve për hedhjen e kallëzimeve penale dhe aktvendimeve për pushimin e hetimeve, nevojën për profesionalizimin e prokurorëve dhe të stafit administrativë, si dhe fuqizimin e bashkëpunimit me institucionet vendore dhe ndërkombëtare në mbledhjen dhe shkëmbimin e informatave dhe provave për trajtimin e rasteve në kompetencë të kësaj prokurori.

II. Vizioni juaj për përmirësimin e punës operative në Prokurorinë që keni aplikuar

Ju lutem listoni/përmendni veprimet tuaja afatshkurtra, afatmesme dhe afatgjate:

Si veprime afatshkurtra të mija do të jenë fillimisht analizimi i gjendjes së përgjithshme në Prokurorinë e Apelit, për të parë numrin e lëndëve penale në të gjitha regjistrat, numrin e stafit mbështetës, infrastrukturën dhe mjetet e punës dhe pas këtij analizimit të kësaj gjendje në periudhë afatshkurtër do të marr veprime konkrete me plan të punës 3 mujor, për të ri-organizuar apo plotësuar nevojat e Prokurorisë së Apelit për t'i zvogëluar apo eliminuar problemet që dalin nga kjo analizë.

Në planin afatmesëm, në koordinim dhe në bashkëpunim me të gjithë Kryeprokurorët e prokurorive përkatëse dhe me Këshillin Prokurorial të Kosovës, do të planifikojmë veprime afatmesme në planifikim të prioritizimit dhe zgjedhjes së lëndëve penale me prioritet, posaçërisht ato të cilat lidhen me korrupsionin, krimin

e organizuar, krimet e luftës, dhuna në familje, terrorizmi dhe vepra tjera penale karakteristike.

Në planin afatgjatë, orientimi ynë do të jetë në zbatimin e planit strategjik të sistemit prokurorial, posaçërisht në realizimin e objektivave që dalin për Prokurorin e Shtetit, që janë profesionalizmi dhe pavarësia, efikasiteti dhe efektiviteti i ndjekjes së kryesve të veprave penale, e posaçërisht atyre me prioritet, integriteti dhe llogaridhënia.

Përkushtim i veçantë në planin afatgjatë do të jetë mbikëqyrja e vendimeve lidhur me lëndët më luftimin dhe ndjekjen e kryerësve të veprave penale-zyrtarëve të lartë për korrupsion dhe krim ekonomik, sekuestrimi, me qëllim të konfiskimit përfundimtar për pasurinë e fituar në mënyrë të kundërligjshme, dhe dhënia e propozimeve për profilizimin e prokurorëve në fusha të caktuara, posaçërisht tek vepra penale të krimit të organizuar.

Mbikëqyrja e prokurorëve dhe punës së tyre lidhur me aktet prokuroriale, duke përfshirë edhe mbikëqyrjen e zbatimit të Kodit të Etikës dhe Sjelljes Profesionale për prokuror, unifikimi i praktikave dhe formave të shkresa prokuroriale dhe përfaqësimi adekuat në seanca gjyqësore dhe të kolegjeve, ngritjen e kapaciteteve njerëzore dhe profesionale për të ushtruar në mënyrë efektive, obligimet e tyre profesionale në luftimin e të gjitha formave të kriminalitetit brenda afateve ligjore, që prokurorët të jenë të përgatitur dhe të gatshëm që të trajtojnë rastet më komplekse dhe më të ndërlikuar, ku janë të involvuar personat e profilit të lartë.

1. Cili është vizioni juaj për të përmirësuar punën operative gjatë mandatit tuaj?

Në të ardhmen, sistemi prokurorial do të përballë me situata, që kanë të bëjnë me konsolidimin e sistemit të drejtësisë në përgjithësi, në kuadër të cilit funksionin edhe Prokuroria e Apelit, ajo që është në vëmendje të publikut, të institucioneve vendore dhe ndërkombëtare, është që Prokuroria e Apelit, duhet të rikthejë besimin e publikut, duke krijuar një sistem të pavarur, të paanshëm, me integritet, efikas dhe profesional, i cili sistem do të punojë në kuadër të standardeve ndërkombëtare, ku do të sigurojë zbatimin e ligjit, duke i trajtuar qytetarët në mënyrë të barabartë dhe duke mos lejuar që askush të jetë mbi ligjin, parimet e sistemit nuk do të jenë privilegj i Prokurorit të Shtetit, por garanci e qytetarëve pa dallim.

Prokurori i Shtetit, duhet të krijojë integritet moral dhe profesional në përputhje me standardet ndërkombëtare, që të funksionoj pa ndikimin e interesave, të ngushta të grupeve të interesit dhe pushteteve tjera, ku kjo është edhe garanci me Kushtetutën e Republikës së Kosovës, e që është përcaktuar si institucion i pavarur, i paanshëm dhe profesional.

Për të ushtruar detyrat e tij sipas parimeve bazike, Prokurorisë së Apelit duhet t'i krijohen kushtet e përshtatshme për punë.

Prokurori i Shtetit, për të promovuar këto aktivitetet të drejta dhe efikase, duhet të vendosim metodat hierarkike të organizimit të brendshëm, duke mos lejuar që këto metoda, të rezultojnë në krijimin e strukturave burokratike, ku qëllimi i institucionit është të funksionoj në mënyrë hierarkike.

Qëllimi i institucionit të Prokurorit të Shtetit, parasheh që Prokurorët të Shtetit të jenë profesional në zhvillimin e hetimeve dhe akteve të tjera prokuroriale, po ashtu të jetë edhe përfaqësimi i akteve në mënyrë sa më profesionale, për të respektuar të drejtat themelore të njeriut.

2. Cilat janë objektivat tuaja kryesore?

Sot në vëmendjen e publikut është që institucioni i Prokurorit të Shtetit, duhet të rikthejë besimin e publikut, ngase rikthimi i besimit të publikut është shumë i rëndësishëm, që Prokurorët të Shtetit, të ndihen më të sigurt në punën e tyre, që të kenë autoritet dhe kredibilitet më të madh, me rezultatet të mira të treguara, në hetimin, zbulimin, procedimin e akteve akuzuese, dënueshmërisë së kryerësve të veprave penale dhe konfiskimin e pasurisë, do të kthehet besimi i publikut ndaj institucionit të Prokurorit të Shtetit, ku do të jetë edhe motiv i punës së prokurorëve.

Në këtë drejtim duhet të forcojmë perceptimet e përgjithshme se veprimet e prokurorëve janë të drejta, ligjore dhe të përshtatshme brenda një sistemit të normave, besimeve dhe përkufizimeve, e që kjo do të bëjë që qytetarët do të kenë besim në procedurat e ndjekjes, të cilat do të ndërmerren nga ana e Prokurorëve të Shtetit, prandaj do të marrim masa si në vijim:

- Rritja e efikasitetit dhe efektivitetit të trajtimit të lëndëve, në luftimin kundër korrupsionit, krimeve ekonomike, pastrimit të parave, terrorizmi, krimin kibernetike dhe krimin të organizuar.
- Administrimi dhe mbikëqyrja efikase, llogaridhënia e vazhdueshme e punës së prokurorëve, si dhe stafit administrativ.
- Unifikimi i shkresave prokuroriale dhe praktikave më të mira të punës në institucionin e Prokurorit të Shtetit.
- Rritja e transparencës dhe besimit të publikut.
- Bashkëpunimi ndërinstytucional me institucionet e sistemit të drejtësisë dhe fuqizimi i bashkëpunimit me partnerët ndërkombëtar.
- Llogaridhënia dhe etika profesionale.

Për realizimin e këtyre objektiveve, duhet punuar në përfitimin apo marrjes së përkrahjes së mediave, shoqërisë civile dhe të qytetarëve, për ta ndërruar

mentalitetin në raport me institucionin e Prokurorisë së Apelit dhe në përgjithësi të Prokurorit të Shtetit.

3. Cilat janë vështirësitë apo rreziqet që prisni gjatë përmbushjes së këtyre objektivave?

Konsiderojë se vështirësitë që do të mund të paraqiten gjatë përmbushjes së objektivave, janë numri i madh i lëndëve por edhe i ankesave të paraqitura kundër aktvendimeve për hedhjen e kallëzimeve penale dhe ankesave kundër aktvendimit për pushimin e hetimeve, mungesa e kushteve, mungesa e trajnimeve të stafit administrativ, zbatimi i projektit elektronik SMIL dhe ndërlidhja me organet tjera të zbatimit të ligjit. Mos rekrutimi i bashkëpunëtorëve profesional dhe stafit mbështetës.

4. Si do t'i tejkalojnë ato?

Sfidat dhe rreziqet që mund të paraqiten me rastin e zbatimit të objektivave të Prokurorit të Shtetit, pa dyshim mund të jenë sfiduese, por përmes një planifikimit të mirë me veprime dhe aktivitete konkrete, me koordinim të plotë me të gjithë drejtuesit e zyrave prokuroriale dhe bashkëpunim të ngushtë me partnerët vendor dhe ndërkombëtar dhe institucionet e shtetit të Republikës së Kosovës, konsideroj se mund t'i tejkalojnë këto vështirësi.

III. Vizioni për të menaxhuar personelin në sistemin prokurorial

Ju lutem renditni hapat konkretë që do t'i ndërmerrenit gjatë mandatit tuaj?

Administrata e Prokurorit të Shtetit -Apelit, pa dyshim është mekanizim shumë i rëndësishëm në kryerjen e përgjegjësisë dhe mandatit të Prokurorit të Shtetit, andaj një nga përkushtimet e mija, do të jetë ndërmarrja e veprimeve konkrete në drejtim të forcimit, avancimit të stafit mbështetës, përmes hapave konkret.

- Organizmi i Administratës në bazë të nevojave të paraqitura brenda Prokurorisë së Apelit
- Trajnimet adekuate dhe specifike sipas nevojës.
- Rritja e përgjegjësisë në kryerjen e detyrave të punës.
- Llogaridhënia.
- Zbatimi i parimeve të pavarësisë, neutralitetit, paanshmërisë, konfidencialitetit, efikasitetit dhe efektshmërisë.
- Puna ekipore.
- Angazhimi shtesë në detyrat e caktuara.

1. Cilat janë metodat dhe mënyrat tuaja për menaxhimin e stafit?

Viteve të fundit, janë bërë ndryshime të mëdha brenda sistemit prokurorial, si dhe rritja e numrit të prokurorëve në sistemin prokurorial dhe stafit mbështetës, një pjesë e tyre nuk kanë qenë të trajnuar dhe me qëllim të rritjes së efikasitetit të punës së stafit, do t'i jepet mundësia që të marrin pjesë në trajnime të ndryshme, të përfitimit të përvojave të reja në aspektin profesional përmes metodës së krahasimit në mes të prokurorive dhe vendeve të ndryshme të rajonit, e të cilat përvoja do t'i aplikojnë në vendet e tyre të punës. Organizimi i punës do të jetë i përshtatshëm për të gjithë stafin me qëllim të kryerjes së punës në mënyrë sa më efektive dhe efikase.

Vizioni i Prokurorit të Shtetit, parasheh që të ketë menaxhim të mirë për personelin mbështetës, që të ketë llogaridhënie, transparencë, të mos ketë ndërhyrje hierarkike nga eprorët, e as nga institucionet e tjera në autonominë e prokurorëve në procesin e vendimmarrjes, çdo ndërhyrje qoftë nga brenda apo nga jashtë në punën e prokurorit, do të ndërmerren masat adekuate ligjore ndaj ndërhyrësve.

Një përkushtim i veçantë do të jetë në mbikëqyrjen e sjelljes të tyre personale dhe profesionale, me rastin e trajtimit të kërkesave dhe ankesave të palëve.

2. Si planifikoni të ndërtoni një sistem të zhvillimit në karrierë për stafin?

Në të ardhmen do të përpiqem që nëpërmjet mekanizmave të Sekretariatit të KPK-së, të bëjmë ndarjen e detyrave në mënyrë të drejtë dhe proporcionale me gjithë stafin mbështetës, me përshkrimin e detyrave të punës. Fokus te veçantë do te paraqesim në shkrimoren e prokurorisë, ku bëhet regjistrimi elektronik i lëndëve sipas departamenteve, e po ashtu do të kemi kujdes të veçantë në ndarjen e lëndëve në mënyrë automatike përmes sistemit elektronik "SMIL".

3. Si planifikoni të përmirësoni llogaridhënien dhe profesionalizmin e stafit?

Me qëllim të administrimit sa më efikas të sistemit prokurorial gjatë punës time si udhëheqës i institucionit të Prokurorisë së Apelit, do të fokusohem në ngritjen e kualitetit të punës përmes trajnimeve të vazhdueshme për tema sipas nevojave, gjithashtu duke mbajtur takime të rregulla, ku do të diskutohet lidhur me rastet të ndryshme nga praktika për ngritjen e profesionalizmit të stafit mbështetës, kurse sa i përket llogaridhënies nuk do të hezitohmë asnjëherë që të kërkojmë llogari nga stafi lidhur me detyrat e tyre të punës, çdo herë duke respektuar aktet ligjore dhe nënligjore.

IV. Hapat që do të ndërmerri për përmirësimin e integritetit dhe llogaridhënies së sistemit dhe besimit të publikut?

Ju lutem listoni/përmendni veprimet tuja afatshkurtra, afatmesme dhe afatgjata:

Llogaridhënia mbetet një prej elementeve më të rëndësishme për një sistem prokurorial, me ç'rast prokurorët i ndërmarrin veprimet e tyre bazuar në vlerat më të larta që i përkasin një shoqërie, në të cilën mbisundon rendi dhe ligji.

Prokurori i Shtetit në periudhë afatshkurtër mbetet i përkushtuar të bëjë fillimisht analizimin e të gjeturave lidhur me integritetin dhe llogaridhënien, e pastaj në bazë të të gjeturave, do të veprojë për të avancuar sistemin e mbikëqyrjes së punës të prokurorëve dhe llogaridhënies për të ngritur vazhdimisht nivelin e cilësisë, profesionalizmit, sjelljes dhe efikasitetit me rastin e trajtimit të rasteve penale.

Në periudhën afatmesme do të ndërmerren veprime konkrete për të mbajtur prokurorët përgjegjës dhe llogaridhënës do të realizohen përmes vizitave të rregullta nëpër prokuroritë e Republikës së Kosovës, me qëllim që të marrë informata sa më të sakta për të dhënë udhëzimet e nevojshëm, që do të ndihmonin realizimin e përgjegjësiave ligjore dhe kushtetuese.

Në periudhën afatgjate, do të merren të gjitha këto veprime për të rritur besimin e publikut, duke ngritur nivelin e vlerësimit të punës, një vëmendje e veçantë do t'i kushtohet se sa kanë qenë të përgjegjshëm prokurorët dhe llogaridhënës për rastet që i kanë trajtuar dhe sidomos nëse kanë treguar neglizhencë gjatë punës së tyre.

Gjatë angazhimit për llogaridhënie sistematike, do të kërkojmë raporte me shkrim në baza të rregullta për të parë ecurinë e trajtimit të rasteve penale, praktikat e përdorura dhe rezultatet e treguara.

Takimet në kolegjiunet e Kryeprokurorit do të jenë një nga praktikat e mira që do të vazhdojnë për të ngritur llogaridhënien dhe integritetin, që bashkërisht të diskutohen dilemat eventuale të paraqitura, por edhe zgjedhjet e propozuara.

1. Hapat që do të ndërmerrni për të ngritur nivelin e besueshmërisë së sistemit prokurorial duke vënë një baraspeshë mes transparencës dhe konfidencialitetit të procedurës?

Duke pasur parasysh faktin se ngritja e nivelit të besueshmërisë në prokurori është shumë e nevojshme me përmirësimin e llogaridhënës, transparencës, integritetit dhe profesionalizmit, ku do të ngritet niveli i besueshmërisë së publikut.

Gjatë informimit të publikut do të jemi të kujdesshëm që të mbajmë një baraspeshë në mes të ruajtjes së hetimeve për rastet që është duke ndjekur penalisht dhe interesit të përgjithshëm për informim të publikut.

Ngritja e vazhdueshme e transparencës nxjerr në pah nevojën e vazhdimin të aktiviteteve, të cilat e paraqesin transparent institucionin e Prokurorit të Shtetit,

gjithashtu, hartimi i politikave të reja të komunikimit është nevojë për ngritjen e transparencës, gjë që nënkupton edhe ngritjen e besueshmërisë.

Prokurori i Shtetit parasheh objektiva, të cilat kanë në fokus realizimin e aktiviteteve të menduara mirë që kanë për qëllim ngritjen e transparencës dhe besimit të qytetarëve në punën e Prokurorit të Shtetit.

Do të avancojmë komunikimin e brendshëm dhe të jashtëm, do të angazhohemi të kemi komunikim proaktiv me mediat, publikun dhe shoqërinë civile dhe koordinimin me institucionet e tjera të sistemit të drejtësisë, të parapara për përmirësimin e komunikimit dhe rritjes së transparencës.

2. Çfarë planifikoni të ndërmerrni për të siguruar një punë cilësore të prokurorëve?

Në të ardhmen fokusi im kryesor do të jetë në ngritjen e cilësisë së punës të prokurorëve, duke marr parasysh faktin që tani nuk kemi ngarkesë të madhe me lëndë të rregullta, do të ndërmarr hapa konkret në ngritjen e cilësisë, çdo hujtje e kallëzimit penal, pushim i hetimeve, ndryshimet e kualifikimeve juridike të veprave penale, caktimi dhe ndërrimin e masave të sigurisë së të pandehurit në procedurë penale dhe heqje dorë nga ndjekje penale, do të bëhen në mbikëqyrje të Kryeprokurorëve të prokurorive përkatëse. Fokus tjetër i yni do të jetë, raportimi i rregullt i Kryeprokurorëve lidhur me punën cilësore të çdo prokurorit, e në veçanti raportim të veçante për rastet e ndjeshme të cilat kërkojnë urgjencë për shkak të natyrës së tyre dhe interesit të përgjithshëm.

Ngritjen e cilësisë planifikojmë ta bëjmë edhe përmes prokurorëve të Zyrës së Kryeprokurorit të Shtetit, të cilët do të mbikëqyrin prokurorit përmes kolegjiuemeve të rregullta të prokurorive përkatëse. Vlerësojmë se në ngritjen e punës cilësore do të ndikoj edhe angazhimi i prokurorëve koordinator në fushat e caktuara.


3. Çfarë planifikoni të përmirësoni në llogaridhënien e përgjithshme në prokurorinë tuaj?

Me qëllim të funksionimit sa më të mirë të sistemit prokurorial, planifikojmë të ndërmarrim veprime më qëllim të përmirësimit të llogaridhënies, ashtu që do të kërkohe në vazhdimësi nga të gjithë prokurorët por edhe stafi mbështetës që të kryejnë detyrat e tyre duke respektuar plotësisht ligjin dhe kodin e etikës, të mbrojnë interesin e institucionit të Prokurorit të Shtetit, të respektojnë liritë dhe të drejtat e njeriut, të jenë të përgjegjshëm në punë, të jenë efikas dhe të kenë integritet të lartë moral dhe profesional, si në punën e tyre në zyrë ashtu edhe gjatë përfaqësimit të lëndëve në gjykatë.

Koncept dokumenti nuk duhet të përmbajë më shumë se 10 faqe me shkrimin e llojit Book Antiqua, madhësia 12, hapësira njëshe.

Deklaroj se përmbajtjen e këtij Koncept dokumenti e kam përgatitur vetë dhe jam në dijeni se i njëjti do të publikohet në uebportal.

Nënshkrimi: _____

A handwritten signature in black ink, appearing to be 'R. B. T. J.', written over a horizontal line.

Datë: 07.11.2024